

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Grabitje spektakolare në banesën e kardinalit Ernest Simoni në Firenze/ Hajdutët shembin murin për tu futur brenda, i marrin sende me vlerë dhe lejen e qëndrimit
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/grabitje-spektakolare-ne-banesen-e-kardinalit-ernest-simoni-ne-firenc-i514864
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 15:41:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:18:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ebdf1eff9e310f609c08a0d8adc8d4e739b571b5a973758d9fd11fb2ace1d377
TEKSTI	0cb8c7a948940baef03573b0cada9837bc6c2a3128b4f2189fe1bccba26f9ce0
PAMJA	45b1b932cf3acaa6cac57d2ed2f52de0e479f3adfeeb7ad586d98626bbd05291

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8ec7be1b1a602e36c15f4de72c88fa186120b4d9bc712ea02950c4ef2f843a04
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8ec7be1b1a602e36c15f4de72c88fa186120b4d9bc712ea02950c4ef2f843a04>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

5 ORE ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

7 ORE ME PARE

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkojë rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

21 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhën sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

1 DITE ME PARE

Vendimi i Hagës nxiti protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

Aktualitet

Grabitje spektakolare në banesën e kardinalit Ernest Simoni në Firenze/ Hajdutët shembin murin për tu futur brenda, i marrin sende me vlerë dhe lejen e qëndrimit

Ngjarja ka ndodhur në apartamentin që ndodhet në Piazza Duomo, në një banesë të Kurisë, ku 97-vjeçari jeton së bashku me nipin e tij, Tonin Simoni.



18 Shtator 2026, 17:18
Nga E. D



Kardinali Ernest Simoni dhe pamje nga grabitja

ITALI- Një grabitje spektakolare ka ndodhur në banesën e kardinalit shqiptar Ernest Simoni, në Firences. Sipas [mediave](#) italiane, grabitësit kishin shembur një pjesë të murit pranë derës së blinduar dhe më pas e kanë hapur atë me forcë. Ngjarja ka ndodhur në apartamentin që ndodhet në Piazza Duomo, në një banesë të Kurisë, ku 97-vjeçari jeton së bashku me nipin e tij, Tonin Simoni.

Në momentin e grabitjes, askush nuk ndodhej në banesë. Kardinali Ernest Simoni ishte në Londër, ku ndodhej për një takim me Mbretin Charles III, ndërsa nipi i tij dhe bashkëshortja ishin larguar nga shtëpia rreth orës 13:00, por kur u kthyen, ata gjetën banesën të përmbytur. Autorët kishin kontrolluar të gjitha dhomat, duke hapur garderoibat, valixhet, sirtarët dhe kasetat në kërkim të sendeve me vlerë.

Një nga elementet që ka tërhequr më shumë vëmendjen e hetuesve është mënyra dhe koha e realizimit të grabitjes. Shembja e murit dhe hapja e derës së blinduar me mjete të forta duhet të kenë shkaktuar zhurmë të konsiderueshme. Megjithatë, deri në momentin e kthimit të familjarëve, askush nuk kishte raportuar se kishte dëgjuar apo parë diçka të dyshimtë.

Madje, sipas raportimeve, as prifti që banon në katin poshtë apartamentit nuk kishte vënë re gjë. Ai dyshon se autorët e kishin studiuar më parë banesën dhe lëvizjet e banorëve. Nga banesa u morën para në dorë, sende floriri, bizhuteri të bashkëshortes së Toninit, medalje dhe një vulë floriri. Mes sendeve të vjedhura ishte edhe leja e qëndrimit e kardinalit Ernest Simoni, e cila mbahej në një sirtar.

Pas denoncimit, në vendngjarje mbërritën karabinierët dhe ekspertët e policisë shkencore, të cilët kryen këqyrjen e apartamentit dhe po kërkojnë gjurmë që mund të çojnë te autorët. Në fokus të hetimit janë edhe kamerat e shumta

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 10:36

"O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke"/ Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit (VIDEO)

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 09:22

Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

të sigurisë në Piazza Duomo, një prej zonave më të monitoruara të Firences.

Pas zbulimit të grabitjes, Tonin Simoni telefonoi menjëherë xhaxhain e tij në Londër për ta vënë në dijeni. Megjithatë, reagimi i kardinalit nuk lidhej me paratë apo sendet e tjera të vjedhura. Sipas nipit të tij, pyetja e parë e Ernest Simonit ishte nëse hajdutët kishin prekur statujat fetare që ai mban në dhomën e tij, e cila ngjan me një kapelë të vogël.

Ai pyeti veçanërisht për statujën e Zojës së Medjugorjes dhe atë të Atë Pios. Hetimi për grabitjen vijon, ndërsa autoritetet po analizojnë pamjet e kamerave të sigurisë dhe provat e mbledhura në apartament, për të përcaktuar identitetin e autorëve dhe mënyrën se si kanë arritur të kryejnë grabitjen në një nga zonat më të kontrolluara të Firences./Dosja.al

ernest simoni itali

Sondazh

Poll



Aktualitet 18 Shtator 2026, 16:24

VIDEOLAJM/ Zjarr në sektorin Rinia në Durrës, banorët dhe zjarrfikësit në luftë me flakët

pamjet DURRËS- Një vatër zjarri ka përfshirë një fushë të madhe me shkurre në sektorin Rinia. Të favorizu...

OSBE-ja e gatshme të mbledhë votat në Kosovë për zgjedhjet serbe, por pret miratimin e institucioneve të Kosovës

Aktualitet 18 Shtator 2026, 16:26

Pagat e magjistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...

Aktualitet 18 Shtator 2026, 16:20

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

më të klikuarat

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj del nga qelia, kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti European i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditit Latinopoulou

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm ‘Marbella’/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Gjykata Speciale e dënoi me 25 vite burg/ Reagon Thaçi: Mirënjohje popullit të Kosovës për mbështetjen, do ta apelojmë vendimin e Hagës

insights

Auron Janku Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

Kuvendi miratoi rormulen e re te pagave, magjistratët nuk tërhiquen: Do e çojmë në Gjykatën Kushtetuese

Aktualitet
18 Shtator 2026, 15:28

Ndryshime në Autoritetin e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar/ Largohet Altin Jani, zëvendësohet nga Ermal Jauri

Aktualitet
18 Shtator 2026, 14:50

Aktualitet
18 Shtator 2026, 14:39

Aksident rrugor në Elbasan, plagoset një grua dhe një fëmijë

Pamje ELBASAN- Një aksident rrugor ka ndodhur në qytetin e Elbasanit, ku një një automjet është përplasur me barrierat m...

U votua gjatë natës në Kuvend, botohet në Fletoren Zyrtare formula e pagave të magjistratëve

Aktualitet
18 Shtator 2026, 14:31

Largoi 950 mijë € verë nga vila e Ergys Agasit, Gjykata e Tiranës lë në burg kushëririn e tij, Eno Agasin

Aktualitet
18 Shtator 2026, 13:50

Aksident në aksin Elbasan-Librazhd/ Përplasen dy automjete, nuk ka të plagosur

Aktualitet
18 Shtator 2026, 13:43

I riu rrëshqet aksidentalisht në një lokal dhe pëson dëmtime në kokë, niset me helikopter drejt Traumës

Aktualitet

18 Shtator 2026, 13:18

MË SHUMË



Rama: Euro e dobët, duhet reflektim te çmimet



Rama: Euro e dobët, duhet reflektim te çmimet

Zjarr në sektorin Rinia në Durrës, banorët dhe zjarrfikësit në luftë me flakët

Rama takime me furnitorë: Po fitoni më shumë se ç'e mban zakoni i mirë

Djali i Jakup Krasniqit: Nuk dorëzohemi, ajo që ndodhi në Hagë prek sakrificën e çdo dëshmori

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP NGA MediasDesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.